



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit:22.10.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË FUSHË
KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Fushë Kosovës në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrë auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga Mehmet Muçaj (udhëheqës ekipi) dhe Shpresa Zenelaj (anëtar).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
2 Qeverisja.....	11
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	17
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	27
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	28
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak	31


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Fushë Kosovës (më tutje: komuna) për vitin 2015, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Dëshirojmë të falënderojmë Kryetarin e Komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat kemi menduar se janë të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Vjetore Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të datës 06.10.2015.

Auditimi ynë është fokusuar në:



(Më hollësisht, shih shtojcën I të këtij raporti)

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 është përcaktuar nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

“Opinion i kualifikuar” sepse komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria investime kapitale ishin paguar 227,119€ për mallra dhe shërbime të pa planifikuara me buxhet.

Theksimi i çështjes


Gjithashtu, kishte edhe keqklasifikime tjera, por që ishin buxhetuar gabimisht nëpër kategori ekonomike jo adekuate. Përveç kësaj, pasuritë e komunës ishin mbivlerësuar për 65,429,156€.

Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi në kapitulli 1.2 i këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Sistemi i kontrollit të brendshëm në aspektin e raportimeve në nivelin e tanishëm nuk ofron sigurinë se aktivitetet operative dhe financiare të komunës kryhen në mënyrë efektive, dhe si i tillë, ka nevojë për një mbikëqyrje të shtuar dhe përmirësim në disa fusha.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Dobësi në procesin e planifikimit
buxhetor dhe mangësi gjatë ekzekutimit



Kryetari duhet të siguroj që
performanca buxhetore është
monitoruar në mënyrë sistematike në
baza mujore dhe adreson barrierat për
realizim të buxhetit në nivel të
planifikuar (shih çështjen 7)

Përgjigjja e Menaxhmentit në auditimin e vitit 2015

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

Ne e konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari:

- Do ta shqyrtoj raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2017, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF e vitit 2016 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne, gjithashtu, shqyrtojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

PËR KOMUNËN E FUSHË KOSOVËS

OPINIONI I KUALIFIKUAR ME THEKSIM TE ÇËSHTJES

Ne kemi audituar Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Fushë Kosovës për vitin e përfunduar më 31.12.2015, të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme', 'Pasqyra e Krahimit të Shumave Buxhetore dhe Aktuale', Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Vjetore Financiare si dhe Shpalosjet.

Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Vjetore Financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, të pranimeve dhe të pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të Komunës së Fushë Kosovës për vitin e përfunduar më 31.12.2015, në përputhje me: Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme); Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën Financiare të Ministrisë së Financave nr. 03/2013 për Pasqyrat Vjetore Financiare të organizatave buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

Komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar 164,510€ në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit me Caritas Kosovën për financimin e një projekti për shërbime shëndetësore, si dhe shumën prej 62,609€ për mallra dhe shërbime.

Kjo ka rezultuar në një gabim material në mbivlerësimin e investimeve kapitale dhe nënvlerësimin e mallrave dhe shërbimeve në Pasqyrat Vjetore Financiare. Për këtë arsye ne kemi kualifikuar opinionin tonë.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa për Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të Pasqyrave Vjetore Financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga komuna dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushë në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që janë marrë, janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion të kualifikuar.

Theksim i çështjes

Komuna, gjithashtu kishte bërë financime nga investimet kapitale për mallra/shërbime dhe subvencione e transfere edhe shumën totale prej 408,254€. Arsyeja e keqklasifikimit ishte planifikimi jo i mirë i buxhetit për kategori ekonomike. Vlen të sqarohet se shuma prej 408,254€ ishte e aprovuar me tabelat buxhetore të Buxhetit 2015 për investime kapitale, por projektet e paraqitura në tabela, nuk përmbushin kushtet të trajtohen si projekte kapitale, dhe gabimet kanë të bëjnë me planifikimet fillestare nga komuna dhe aprovimet jo adekuate nga ana e MF.

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen se Regjistri i Pasurive Fikse nuk konfirmon gjendjen e plotë të pasurive, sepse në totalin e pasurive (210,278,703€), ishin përfshirë edhe tokat pyjore dhe disa prona shoqërore në vlerë 65,429,156€ që sipas listave poseduese figurojnë si prona shoqërore, dhe jo si pasuri komunale. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këto çështje.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të PVF sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e PVF pa keqdeklarime materiale, të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për Pasqyrat Vjetore Financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe

ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse Pasqyrat Vjetore Financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritët që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e Pasqyrave Vjetore Financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të Pasqyrave Vjetore Financiare.

1.3 Rreziqet domethënëse në PVF

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 06.10.2015, janë identifikuar tri rreziqe për PVF-të. Këto janë rreziqe të keqdeklarimeve materiale, të cilat mund të rezultojnë me modifikim të opinionit ose në theksim të çështjes. Rreziqet e planifikuara kanë të bëjnë me palët e treta, mungesa e regjistrit të plotë të pasurisë si dhe klasifikimin e gabuar të shpenzimeve.

Rreziku i regjistrimit të pasurisë – Edhe përkundër angazhimeve të komunës në adresimin e këtij rekomandimi, ende regjistri i pasurive nuk është i besueshëm. Ne përmes disa mostrave identifikuam që në këtë regjistrë janë të përfshira edhe prona të cilat nuk menaxhohen nga komuna. Prandaj konsiderojmë që nuk kemi një siguri lidhur me plotësinë e këtij regjistri.

Rreziku i keqklasifikimit - Ne kemi identifikuar që menaxhmenti nuk ka ndërmarr veprime konkrete për të adresuar rekomandimin lidhur me keqklasifikimin e shpenzimeve. Nga kategoria e investimeve kapitale janë kryer pagesa në vlerë totale 635,373€, prej tyre, të parashikuara me buxhet ishin 408,254€ dhe 227,119€ ishin të pa planifikuara.

Rreziku i tretë domethënëses që ka të bëjë me prezantimin e pagesave të palëve të treta, nuk është materializuar sepse menaxhmenti ka ndërmarr veprimet e duhura gjatë vitit 2015 për të siguruar se pagesat nga palët e treta janë regjistruar në PVF dhe në Thesar.

1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të veprojë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare MF nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me plotësime dhe ndryshime);
- Pajtueshmërinë me kërkesat buxhetore;
- Raportimet tremujore në Kuvendin Komunal; dhe
- Planin e prokurimit; dhe
- Raportimin e progresit të investimeve kapitale mbi 10,000€.

Në kontekst të kërkesave për raportim, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

Çështja 1 – Gabimet në PVF - Prioritet i lartë

E gjetura Çështjet që janë prezantuar gabimisht në pasqyra janë si më poshtë:

Nga kategoria e investimeve kapitale janë kryer pagesa në vlerë totale 635,373€. Nga shuma totale e keqklasifikimeve prej 635,373€, vlen të përmendet se 408,254€ ishin të parashikuara gabimisht me tabelat buxhetore në kategorinë e investimeve kapitale, ndërkaj në përmbushin kushtin që të trajtohen si të tilla.

Në nenin 16 shpalosja e pasurive - pasuritë komunale janë prezantuar në shumë 210,278,703€, ndërsa në këtë shumë ishin përfshirë edhe tokat pyjore dhe disa prona shoqërore në vlerë 65,429,156€ që sipas listave poseduese figurojnë si prona shoqërore, dhe jo si pasuri komunale.

1.5 Rekomandimet

Rekomandimi 1 Prioritet i lartë - Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura, përfshirë rreziqet domethënëse për keqklasifikim të shpenzimeve dhe shpalosjen e pasurive. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon përkushtimin e menaxhmentit që t'i zhvilloj dhe avancoj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetëvlerësimit që është plotësuar nga komuna siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente për të përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetëvlerësim dhe për të vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në komunë.

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rrezikut, zbatimin e objektivave strategjike dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit, e plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi aranzhimet ekzistuese që nuk bazohen aq sa duhet në dëshmi. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi të auditimit të brendshëm në nivel më cilësor, nuk janë të vendosura.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e komunës për vitin 2014 ka rezultuar me 20 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku përcaktohen veprimet dhe afatet për implementimin e rekomandimeve të dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, pesë (5) rekomandime ishin implementuar, gjashtë (6) ishin adresuar dhe janë proces të implementimit, dhe nëntë (9) nuk ishin adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Është për t'u vlerësuar fakti se Raporti i auditimit ishte diskutuar edhe në Kuvendin Komunal, çka ndikon në rritjen e transparencës dhe shqyrtimin më kritik të aktiviteteve të komunës.

Çështja 2 – Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura	Edhe përkundër planit të veprimit për korrigjimin e mangësive dhe dobësive, vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë implementuar. Komuna ka aplikuar një proces formal të kontrollit të procesit, megjithatë nuk kishte arritur të menaxhoj dhe monitoroj në tërësi implementimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm.
Rreziku	Dobësitë e përsëritura të kontrolleve të menaxhmentit në sistemet financiare dhe fushat tjera të veprimtarisë kanë rezultuar në: • Projektet kapitale nuk janë planifikuar në mënyrën e duhur; • Keqklasifikim të shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate; • Shmangie në disa raste nga kërkesat standarde në procesin e prokurimit; • Mungesa e një rishikimi nga ana e menaxhmentit lidhur me llogaritë e arkëtueshme; dhe • Performancë jo të mjaftueshme nga NJAB dhe aktivitet i mangët nga komiteti i auditimit të brendshëm.
Rekomandimi 2	Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar me adresimin e rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuara me shkallë të lartë rreziku dhe brenda afateve të përcaktuara.

2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetëvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në MF. Më poshtë ne kemi përmbledhur gjetjet tona për komunën. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetëvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për ti mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së si tërësi.

Çështja 3 – Lista kontrolluese e vetëvlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura	Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar disa pyetje kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me komponentët e vlerësuar. Nga çështjet e shqyrtuara kemi gjetur se: 1. Komuna për vitin 2015 nuk kishte Plan Zhvillimor Ekonomik dhe të sektorëve tjerë. Në vitin 2015 Kryetari kishte formuar grupet punuese duke përfshirë nivele të ndryshme komunale për hartimin e Planit të zhvillimit 2016-2020, por dokumenti si i tillë ende nuk ka përfunduar; 2. Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.1; dhe 3. Progresi lidhur me arritjen e objektivave nuk monitorohet rregullisht dhe nuk analizohen shkaqet për dështimet eventuale.
Rreziku	Aranzhimet e dobëta të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.
Rekomandimi 3	Kryetari duhet të siguroj se proceset e qeverisjes pasohen nga planet strategjike, menaxhimi i rrezikut dhe zbatimi i procedurave për matjen e rezultateve kundrejt objektivave.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Komuna duhet të trajtoj vlerësimin e rrezikut operativ dhe strategjik. Udhëzimet e përcaktuara në procedurat e MFK-së kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar, për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

Çështja 4 - Moszbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut- Prioritet i lartë

E gjetura	Pyetësi i vetëvlerësimit i plotësuar nga komuna ka konfirmuar se komuna ende nuk ka vendosur një sistem formal të menaxhimit të rrezikut, për të identifikuar, reaguar dhe marrë masa për të parandaluar ose reduktuar rrezikun në nivel të pranueshëm.
Rreziku	Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëlojë cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve nëse çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë, nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.
Rekomandimi 4	Kryetari duhet të sigurojë se identifikimi, vlerësimi i rrezikut dhe masat për reduktimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, shqyrtohen në nivelet më të larta të menaxhmentit. Më tej, duhet të sigurohet se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës, i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhojë këtë proces dhe do të raportojë në baza të rregullta mbi rreziqet.

2.5.2 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Mirëpo, është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 5 – Dobësi në Kontrollët Menaxheriale – Prioriteti i lartë

- | | |
|----------------------|--|
| E gjetura | Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah mangësitë në aspektin formal të raportimeve të brendshme. Si rezultat i kontrolleve të pamjaftueshme, nuk ka planifikim konsistent të buxhetit, përkatësisht fondeve në dispozicion dhe shpenzimeve. Dhe, për pasojë, kanë ndodhur regjistrime të gabuara të pasurive dhe keqklasifikime të konsiderueshme të shpenzimeve. |
| Rreziku | Cilësia e dobët e raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet komunës në mënyrë pro aktive si dhe ulë efektin e kontrolleve të përgjithshme. |
| Rekomandimi 5 | Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme dhe efektive. |

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NJAB dhe një auditor. NJAB kishte përgatitur planin e auditimit dhe e kishte aprovuar nga menaxhmenti i komunës. Kjo njësi kishte planifikuar të kryej pesë (5) raporte të auditimit ndërsa kishte kryer vetëm tri (3) prej tyre. Ne kemi vlerësuar raportet e AB dhe konsiderojmë që niveli i dokumentimit duhet të përmirësohet. Për të kryer një auditim efektiv, nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet e mundshme financiare me të cilët përballet komuna. Prandaj, raportet e auditimit të brendshëm nuk kishin ofruar siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Çështja 6 – Auditimi i brendshëm - Prioritet i lartë

E gjetura	Ekzistojnë një numër i dobësive në lidhje me operacionet aktuale të NJAB: 1. Vetëm tre nga pesë raporte të planifikuara të auditimit ishin kryer nga AB dhe vetëm një raport ndërlidhet me aktivitetet e vitit 2015. AB nuk kishte mbuluar fushat me rrezik të lartë; si të hyrat vetjake, subvencionet dhe fushat tjera; 2. Dokumentimi i punës së NJAB-it nevojitet të përmirësohet, si dhe të mbahen dëshmitë përkatëse për çdo çështje që ngritët në raportet e auditimit të brendshëm; 3. Rekomandimet e auditimit të brendshëm janë implementuar pjesërisht nga ana e menaxhmentit; dhe 4. Komiteti i Auditimit (KA) në vitin 2015 kishte mbajtur vetëm dy takime të rregullta, ku në njërin ishte diskutuar raporti për shpenzime komunale 2014, dhe në takimin e dytë ishte diskutuar plani strategjik 2016-2018. KA duhet të rishikoj raportet përmbledhëse të auditimit të brendshëm, të gjeturat dhe rekomandimet, si dhe të nxis menaxhmentin e komunës të adresoj çështjet e dala nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm.
Rreziku	Fokusi i auditimit të brendshëm në vitet e kaluara nuk mund t'i shtoj vlerë përmirësimit të aktiviteteve operative dhe cilësisë së kontrolleve të brendshme aktuale. Kryerja e vetëm tri raporteve të auditimit nga NJAB, flet për një mos efikasitet në realizimin e planit vjetor të punës.
Rekomandimi 6	Kryetari duhet të siguroj se Sistemi i auditimit të brendshëm vepron në mënyrë efektive, me fokus parësor në fushat ku rreziqet vlerësohet të jenë të larta dhe se rishikimet trajtojnë çështjet/aktivitetet e vitit aktual. Si fusha me prioritet për auditim mund të jenë: të hyrat vetjake, dhënia e subvencioneve, keqklasifikimet e shpenzimeve që po përsëriten për vite me radhë, etj. Komiteti i auditimit, gjithashtu, duhet të bëjë një plan pune ku do t'i përcaktoj agjendat e punës dhe temat që do t'i trajtoj gjatë vitit.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Sa i përket komunës, planifikimi i buxhetit dhe procesi i ekzekutimit, me theks të veçantë klasifikimi i shpenzimeve, mbetet shqetësim i madh, ku projektet edhe pse planifikohen në tabela buxhetore ato nuk realizohen sipas planifikimit. Këto mund të ndikojnë në vlerë të dobët për para. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të mira, por trajtimi i llogarive të arkëtueshme mbetet sfidë nga komuna pasi që niveli i tyre është 3,140,801€. Megjithatë kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtijshëm për të parandaluar devijimet e mundshme nga kërkesat standarde. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë planifikimi i projekteve kapitale dhe ekzekutimi i buxhetit për këto projekte, prokurimi, si dhe aktiviteti i shtuar për ngritjen e shkallës së inkasimit.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	8,011,259	9,372,876	8,268,351	7,876,173	6,835,394
Granti i Qeverisë -Buxheti	6,188,503	6,405,900	6,399,365	5,934,196	4,930,728
Të bartura nga viti paraprak ² –	0	859,859	793,102	452,821	510,716
Të hyrat vetjake ³	1,822,756	2,034,210	1,055,547	1,489,156	1,384,120
Donacionet e brendshme	0	50,838	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	22,069	20,337	0	9,830

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,361,617€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve (72,907€), të hyrave të bartura (859,859€) si dhe përshtatjeve tjera buxhetore tek të hyrat vetjake (211,454€) dhe grantit të qeverisë (217,397€) pas rishikimit buxhetor.

Në vitin 2015, komuna ka shpenzuar rreth 88% të buxhet final ose 8,268,351€. Realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	8,011,259	9,372,876	8,268,351	7,876,173	6,835,394
Pagat dhe Mëditjet	4,140,000	4,266,208	4,266,183	3,903,283	3,367,728
Mallrat dhe Shërbimet	450,600	847,182	707,486	645,117	572,467
Shërbimet komunale	169,400	169,400	169,390	190,664	200,743
Subvencionet dhe Transferet	334,120	480,516	389,231	711,981	473,631
Investimet Kapitale	2,917,139	3,609,570	2,736,061	4,425,128	2,220,825

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

Pavarësisht rritjes së buxhetit në shumë 692,431€ për kapitale gjatë vitit, ishin shpenzuar 76% e buxhetit. Ky shpenzim relativisht i ultë të investimet kapitale ka ndodhur për shkak se disa kontrata ishin lidhur në fund të vitit 2015 duke u bartur si projekte për realizim në vitin 2016, si dhe dështimi i ekzekutimit të disa kontratave për shkak të kontesteve pronësore.

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e Komunës - pranimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,822,756	2,034,210	2,034,210	2,288,351	1,850,717

Të hyrat vetjake të inkasuara për vitin 2015 kanë shënuar një rënie në krahasim me vitin e kaluar për 254,141€. Të hyrat e planifikuara ishin 1,822,756€ ndërsa ishin mbledhur 2,034,210€.

Çështja 7 - Realizimi i buxhetit - Prioriteti i lartë

E gjetura	Pasqyra e shpenzimeve të fondeve nxjerr në pah një nivel vazhdimisht të ultë të ekzekutimit të buxhetit gjatë viteve, veçanërisht tek investimet kapitale dhe mallrat dhe shërbimet.
Rreziku	Për shkak të planifikimit jo të mirë, në fund të vitit komuna nuk kishte shpenzuar 12% të buxhetit. Si rezultat i kësaj, komuna kishte shmangie në realizimin e shumë objektivave, si në çështjen e mosrealizimit të projekteve kapitale të vitit 2015 dhe në fusha tjera të shpenzimeve.
Rekomandimi 7	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar.

3.4 Prokurimi

Në fushën e prokurimit ne kemi rishikuar 14 procedura të prokurimit në vlerë totale 757,547€. Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshinë kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe ekzekutimin e tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

Kemi identifikuar që në Tabelën 4.2 - Financimi i Investimeve Kapitale Komunale 2015-2017 janë të përfshira edhe projekte që nuk kanë të bëjnë me investime kapitale. Komuna për vitin 2015 kishte planifikuar 60 projekte në vlerë 2,917,139€, ku 13 prej tyre në vlerë prej 768,000€ janë projekte për furnizim me mallra dhe shërbime, si dhe të kategorisë subvencione dhe transfere.

Çështja 8 - Dobësi sistematike në prokurim - Prioritet i lartë

E gjetura	Nga shqyrtimi i procedurave të prokurimit ne kemi identifikuar disa dobësi apo shmangie nga procedurat standarde. Në veçanti, kontrollet menaxheriale nuk kanë funksionuar në mënyrë efektive për të parandaluar çështjet e mëposhtme: Te projektet “Mbjellja e pemëve dekorative në parqe dhe hapësira tjera” (33,976€) dhe “Blerja e një ambulance për nevoja të QKMF-së”(17,420€), kontratat janë nënshkruar me OE para se të deponohet sigurimi i ekzekutimit të kontratës; Në 4 raste identifikua zhvillim të procedurave të prokurimit pa zotim paraprak të fondeve; dhe Në tri raste identifikua që formimi i komisioneve për vlerësim të ofertave nuk ishte bërë në përputhje me LPP dhe Udhëzimin Operativ për Prokurim Publik neni 35.2. Sipas këtij udhëzimi komisioni i vlerësimit duhet të formohet brenda 96 orëve pas hapjes së ofertave, ndërsa në rastet e theksuara më lartë, këto komisione janë formuar pas këtij afati.
Rreziku	Mos respektimi i kriterëve të kërkuara gjatë vlerësimit të ofertave rrit rrezikun që të shpërblehen me kontratë Operatorët Ekonomik të pa përgjegjshëm, dhe hyrja në kontrata pa sigurimin paraprak të fondeve, rritë rrezikun që kontratat të mos realizohen apo të shkaktojnë çrregullime buxhetore.
Rekomandimi 8	Kryetari duhet të siguroj se në tabelat buxhetore për Investime Kapitale të vendosen vetëm ato projekte që janë të natyrës kapitale. Më tej, të kryhet një rishikim i brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet e përmendura, dhe mangësitë e njëjta të mos përsëriten në të ardhmen.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

3.5.1 Pagesat tjera

Komuna kishte bërë shpenzime në bazë të disa marrëveshjeve të mirëkuptimit apo të bashkëpunimit. Si rezultat i planifikimit të dobët të buxhetit, komuna kishte shpenzuar shumën 288,000€ prej investimeve kapitale pa procedura të prokurimit duke u mbështetur në vendime ose marrëveshje bashkëpunimi. Kjo është në kundërshtim me nenin 21 të rregullës financiare 01/2013 për shpenzimin e parave publike, ku për çdo investim nevojitet procedurë e prokurimit. Ne kemi testuar disa pagesa dhe kemi identifikuar mangësitë si më poshtë.

Çështja 9 – Paradhënie për qiranë – Prioritet i lartë

E gjetura	Komuna që nga viti 2012 ka kontratë me një person fizik për marrjen e objektit në shfrytëzim të përkohshëm me qira. Sipas kontratës komuna obligohet të paguaj qira mujore në vlerë 16,450€. Komuna me 28.12.2015 kishte paguar 65,976€, ku nga kjo vlerë 49,526€ ishin paguar si paradhënie për periudhën janar-mars 2016. Kjo mënyrë e pagesës bie ndesh me Rregullën financiare për shpenzimin e parasë publike dhe ligjin e buxhetit. Si rrjedhojë, shpenzimet e paraqitura në PVF 2015 nuk pasqyrojnë gjendjen e drejtë për 49,526€ pasi që ato i referohen tremujorit të parë të vitit 2016.
Rreziku	Pagesat në avanc për mallra dhe shërbime nuk i kontribuojnë një menaxhimi të mirë financiar. Për më tepër, nuk ekziston asnjë arsye për pagesat e qirasë në avanc, përderisa komuna nuk obligohet me kontratën ekzistuese.
Rekomandimi 9	Kryetari duhet të siguroj se kontrollet financiare mbi mënyrën e shpenzimit të mjeteve financiare fuqizohen për të siguruar se të gjitha shpenzimet realizohen duke u bazuar në ligjin e buxhetit dhe rregulloret përkatëse.

Çështja 10 - Marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi - Prioritet i lartë

E gjetura

Me 26.02.2015 Kuvendi Komunal nxori vendim për bashkëpunim me Caritas Kosova për "Ngritja e përkujdesjes sociale, shëndetësore, shtëpiake dhe ambulatore në Fushë Kosovë dhe e obligon Kryetarin e Komunës të lidhë marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me Caritas Kosova për realizimin e projektit. Me 03.03.2015 Kryetari i Komunës e nënshkroi marrëveshjen. Sipas marrëveshjes parashihej "Ngritja e përkujdesjes sociale, shëndetësore, shtëpiake dhe ambulatore në Fushë Kosovë - Home Care III " në vlerë 246,340€. Bazuar në marrëveshje komuna participon vlerën 219,355€ për vitin 2015 ndërsa Caritas Kosova 26,985€. Marrëveshja parasheh që mjetet të transferohen në llogari të Caritasit në 4 këste.

Sipas projektit të Caritasit do duhej të punësohen mbi 60 punëtorë në veprimtari të ndryshme sociale dhe edukative dhe projekti do të fokusohet në mbështetje të moshuarve duke ngritur kujdesin shëndetësor dhe ambulator në QKMF. Ne kemi vërejtur se projekti nuk ishte ekzekutuar, ashtu siç parashikohej ngase në QKMF janë punësuar vetëm 19 punëtorë, ndërsa pjesa tjetër ishin në Arsim (11), Administratë Komunale (17) dhe për pastrim të rrugëve në Drejtorinë e Shërbimeve Publike (21).

Për vitin 2015 komuna kishte paguar në llogari të Caritas Kosova 219,348€ nga projektet e investimeve kapitale sipas marrëveshjes në formë paradhënies pa ndonjë raport të pranimit të shërbimeve. Raporte mujore për kryerjen e aktiviteteve sipas marrëveshjes i janë dorëzuar komunës në baza të rregullta nga ana e Caritasit.

Përveç tjerash, komuna nuk ka ndonjë dëshmi nëse mjetet e zotuar për participim nga donatori, janë shpenzuar për këtë projekt.

Rreziku

Ekzekutimi i pagesave nga komuna para konfirmimit se shërbimet janë pranuar, shoqërohen me rrezikun potencial që objektivat e marrëveshjeve të arrihen pjesërisht apo edhe të mos arrihen. Derisa komuna nuk ushtron mbikëqyrje aktive në realizimin e projekteve dhe nuk posedon asnjë garanci se donatorët do të përfundojnë projektet sipas marrëveshjeve, këto pagesa mund të konsiderohen të parregullta dhe mund t'i shkaktojnë komunës dëme të konsiderueshme financiare.

Rekomandimi 10

Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e bashkëfinancimeve në të ardhmen, do të jetë palë aktive dhe e barabartë në përcjelljen, realizimin dhe mbikëqyrjen e këtyre projekteve. Praktikën e tilla të financimit dhe pagesat e bëra në bazë të këtyre marrëveshjeve duhet të ndërpriten, dhe në vend të kësaj të insistohet që të gjitha pagesat të bëhen vetëm pas pranimit të shërbimeve dhe të bazuara në fatura dhe në bazë të progresit të marrëveshjeve, dhe jo në formë paradhënie.

3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes sistemit të centralizuar qeveritar (payroll). Kontrollat që operojnë në nivel lokal kanë të bëjnë me: a) autorizimin e listës së pagave; b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme; dhe c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori.

Çështja 11 - Pagesat e pagave nga kategoritë tjera buxhetore - Prioritet i Lartë

E gjetura Gjatë rishikimeve tona, kemi identifikuar se komuna kishte bërë kompensimin e pagave për një muaj nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve për 20 të punësuar. Shuma e paguar për këto kompensime ishte në vlerë totale 12,172€. Kjo kishte ndodhur për shkak se komuna këta punëtorë nuk kishte pas mundësi t'i fus në listë të rregullt të pagave. .

Gjithashtu, më 13.03.2015 Kryetari kishte nxjerr vendim për pagesën e orëve shtesë për 38 të punësuar në sektorin e arsimit. Orët shtesë për këta të punësuar ishin paguar nga kategoria subvencione dhe transfere në vlerë 10,966€.

Rreziku Pagesat e kryera më lart tregojnë se nuk ka kontrole të mjaftueshme me rastin e procedimit të pagave. Pagesat e stafit nga kategoritë e mallrave dhe shërbimeve dhe subvencioneve, përveç që nuk është në pajtim me ligjin e buxhetit dhe rregulloren financiare për shpenzimin e parave publike, rrit rrezikun që buxheti i planifikuar për këto kategori të mos mjaftoj për financimin e nevojave operative.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të siguroj se shpenzimet bëhen konform ndarjeve buxhetore dhe se asnjë shpenzim nuk do të bëhet nga kategoria e mallrave/shërbimeve dhe subvencione për kategorinë e pagave dhe mëditjeve.

3.5.3 Subvencionet dhe Transferet

Buxheti i planifikuar për vitin 2015 ishte 440,516€ ndërsa janë shpenzuar 389,231€. Përveç pagesës së orëve shtesë për të punësuar nga kategoria e subvencioneve nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për tu ngritur.

Rekomandim

Nuk kemi rekomandim për këtë fushë.

3.6 Të Hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2015 ishin 2,034,210€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga lejet e ndërtimit, tatimi në pronë, të hyrat nga qiraja, taksat e biznesit etj.

Çështja 12 - Të hyrat vetjake – Prioritet i lartë

E gjetura

Ne kemi testuar të hyrat dhe identifikuar mangësitë si në vijim:

Komuna për vitin 2015 nuk kishte bërë një planifikim të mirë lidhur me mbledhjen e të hyrave. Të hyrat e planifikuara me buxhetin fillestar ishin 1,822,756€, ndërsa kishte inkasuar 2,034,210€. Ne analizuam planifikimin nga këndvështrimi i llojit të hyrave dhe identifikuar që planifikimi jo i mirë ishte për tatimin në pronë dhe për të hyrat nga lejet e ndërtimit. Planifikimi për tatimin në pronë ishte 400,000€ ndërsa inkasimi ishte 530,669€ dhe planifikimi për lejet e ndërtimit ishte 564,756€ ndërsa inkasimi ishte 889,573€.

Në vitin 2015 ishin ngarkuar me taksë vjetore bizneset 140,260€ ndërsa ishin inkasuar 20,571€. Shuma e borxheve të grumbulluara në vitet e kaluar arrin shifrën 667,669€. Gjatë vitit 2015 komuna nuk kishte ndërmarr asnjë veprim për mbledhjen e këtyre e borxheve.

Të hyrat nga shitja e pasurisë (banesat) – Kemi testuar pesë kontrata që ndërlidhen me shitjen e banesave në vitin 2010 dhe kemi identifikuar se blerësit e banesave nuk ju kishin përmbajtur kësteve të parapara në kontratë për të shlyer obligimin ndaj komunës. Borxhi i akumuluar nëpër vite për pesë kontratat ishte 55,285€.

Në një rishikim që i është bërë menaxhimit me kompleksin banesor në fshatin Miradi e Epërme, kemi vërejtur 58 banesa të dhëna me qira, vetëm 22 prej tyre kanë kontrata mbi qiranë, ndërsa të tjerët nuk kanë fare kontrata. Sipas pohimeve të zyrtarëve komunale 36 kërkesa janë në proces të lidhjes së kontratës për qira me komunën. Të hyrat nga ky kompleks banesor ishin 2,386€, ndërsa borxhet 60,013€.

Rreziku

Proceset e dobëta rreth mbledhjes së të hyrave mund të rezultojnë me një nivel të ultë të inkasimit dhe mos realizim të planit për të hyrat. Rrjedhimisht, edhe projektet e planifikuara për t'u financuar nga burimet vetjake, nuk mund të realizohen.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të nxis departamentet përkatëse të komunës që të zbatojnë në mënyrë strikte kërkesat e dispozitave kontraktuese ndaj personave që u janë shitur pronat apo të cilëve këto prona u janë dhënë në shfrytëzim me qira. Po ashtu, një çasje e përmirësuar e planifikimit të të hyrave mund të aplikohet duke marrë në konsiderim analizën e trendit gjatë viteve të fundit, dhe bazën aktuale të ngarkesave të tatimit në pronë dhe ndërtimeve potenciale. Çështje shqyrtimi, duhet të jetë edhe ndërtimi i strategjisë dhe mekanizmave efikas për inkasimin e borxheve nga taksat e biznesit, duke mos përfshirë edhe masat administrative (nëse ka nevojë).

3.7 Pasuritë dhe detyrimet

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Komuna gjatë vitit 2015 kishte adresuar rekomandimin e vitit paraprak për regjistrimin e pasurisë. Kryetari me 13.07.2015 kishte formuar grupin punues komunal prej 12 anëtarëve për vlerësimin e pasurisë jo financiare dhe i njëjti në fund të vitit 2015 kishte hartuar një raport të vlerësimit për pronat komunale. Si rrjedhojë, komuna ka regjistruar pasuritë totale në vlerë 210,278,703€ në regjistrin kontabël, që krahasuar me vitin paraprak (9,436,953€) ka një rritje prej 200,841,750€.

Ne vlerësojmë përkushtimin e treguar të menaxhmentit për të regjistruar dhe mirëmbajtur regjistrin e pasurisë. Përkundër kësaj, gjatë rishikimit të regjistrit të pasurive, ne kemi vërejtur:

Çështja 13 – Regjistrime të gabuara të pasurisë- Prioritet i lartë

E gjetura Regjistri i pasurisë nuk ishte i plotë dhe i saktë. Komisioni për vlerësim të pasurisë kishte regjistruar në regjistrin kontabël pronën në vlerë 65,398,620€ me sipërfaqe 109 hektar(ha.) në fshatin Sllatinë dhe sipërfaqen 1.52 ha. në fshatin Grabovc në vlerë 30,536€ që nuk ishin pronë e komunës. Në evidencat e kadastrit këto prona figurojnë në pronësi të ndërmarrjes së pyjeve që menaxhohet nga Agjencioni Pyjor i Kosovës (APK).

Po ashtu, identifikua se komuna kishte regjistruar gabimisht si pasuri komunale pagesën e bërë në vlerë 20,000€ ndaj "KRM Pastrimi SHA" për furnizim me një kamion special për bartjen e mbeturinave. Sipas marrëveshjes së mirëkuptimit ky automjet do t'i mbetet në pronësi "KRM Pastrimi SHA".

Rreziku Në regjistrin e azhurnuar të pasurive, rreth 30% të pasurive janë të regjistruara gabimisht për shkak të pronësisë kontestuese. Prandaj, regjistri si i tillë, nuk paraqet gjendjen reale të pasurive të prezantuara në PVF, për shkak se ato janë mbivlerësuar në masë të konsiderueshme.

Rekomandimi 13 Përkundër vlerësimit tonë për punën e komisionit, ne rekomandojmë që Kryetari duhet të siguroj që regjistri i pasurisë mbi 1,000€ përmban vetëm pasuritë që janë në pronësi të komunës, dhe procesi i regjistrimit të vazhdoj deri në regjistrimin përfundimtar të të gjitha pasurive.

3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Llogaritë e arkëtueshme të komunës në fund të vitit 2015 ishin 3,140,801€ dhe krahasuar me vitin paraprak (3,342,387€) ato janë zvogëluar për 201,586€ apo rreth 6%. Këto llogari të pa mbledhura janë nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, taksa për ushtrim të veprimtarisë, dhënia e pronave komunale me qira etj. Zvogëlimi i llogarive të arkëtueshme në krahasim me vitin e kaluar ishte si rezultat i rritjes së të hyrave nga tatimi në pronë dhe nga lejet e ndërtimit.

Çështja 14 - Trajtimi i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i mesëm

E gjetura Ne kemi identifikuar një rritje të të arkëtueshmeve për të hyrat nga qiraja, shitja e pasurisë, dhe taksave për ushtrim të veprimtarisë biznesore.

Rreziku Mos arkëtimi i borxheve mund të ndikojë në mos përmbushjen e planit të shpenzimeve. Politikat jo efikase të komunës në trajtimin e këtyre llogarive, kanë rezultuar në rritjen e tyre dhe kjo rritje rrezikun e mos realizimit të projekteve komunale të planifikuara nga burimet vetjake.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të sigurojë iniciimin e një procesi të rivlerësimit, ku të gjitha llogaritë e arkëtueshme do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për inkasim.

3.7.3 Trajtimi i borxheve

Komuna ka një rregullim të brendshëm lidhur me protokollimin e faturave. Ajo gjatë vitit 2015 kishte raportuar obligimet në Thesar në bazë të rregullta mujore. Shuma e obligimeve të cilat i ka raportuar në PVF është 63,572€.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimi të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuar	Të adresuara por jo të implementuar	Të pa adresuara
2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Financiare (çështja 2)	Kryetari duhet të analizojë pse nuk janë ndërmarrë veprimet e duhura për të siguruar vlerë të plotë të pasurive në SIMFK dhe PVF. Kontrollët mbi mirëmbajtjen e regjistrit të pasurive të përfituara gjatë vitit duhet të fuqizohen. Ky proces duhet të jetë nën monitorim direkt nga ana e Kryetarit dhe të përfundojë deri në fund të vitit 2015 .		Komuna ka filluar adresimin e rekomandimeve duke formuar komision të veçantë për trajtim të pasurive. Prandaj komisioni ka bërë vlerësimin e pronave komunale por regjistri nevojitet të azhurnohet pasi që ne identifikuan disa pasuri të cilat nuk ishin të komunës dhe që ishin përfshirë në regjistrin e pasurive komunale. Pra ato ende nuk janë të plota dhe të sakta.	
2.2 Rreziqet domethënëse (çështja 3)	Kryetari duhet të inicioj një diskutim me MF për ta adresuar problemin e mungesës së fondeve për mallra dhe shërbime. Një veprim tjetër i sugjeruar do të ishte që me miratimin e Kuvendit komunal, të bëhen transferet e lejuara (deri në 5%) nga një kategori në kategorinë tjetër buxhetore dhe të mbulohen financimet e domosdoshme në mënyrë të rregullt.		Po- por- Komuna ka bërë kërkesë por kërkesa e tillë është refuzuar nga MF.	

2.3Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim (çështja 4)	Kryetari duhet të sigurojë që procesi i prodhimit të PVF-ve plotësisht adreson dobësitë e identifikuar. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të dorëzohen në Qeveri duhet të nënshkruhet vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës nga ana e menaxhmentit në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e PVF-ve.		x	
3 Rekomandimet e vitit paraprak (çështja 5)	Kryetari duhet të sigurojë një plan të veprimit, të rishikuar, për adresimin e rekomandimeve të mbetura të vitit 2013 dhe ato të vitit 2014. Ky plan duhet të përcaktojë qartë një afat të arsyeshëm kohor të implementimit, stafin përgjegjës dhe mënyrën e zbatimit. Plani duhet të fokusohet fillimisht në fushat me rëndësi të madhe dhe aty ku janë identifikuar dobësi domethënëse. Progresi kundrejt planit duhet të monitorohet direkt nga ana e Kryetarit të Komunës.		Po - pjesërisht	
4.1 Qeverisja e mirë (çështja 6)	Kryetari duhet t'i rishikojë parimet dhe zgjidhjet ekzistuese të qeverisjes së përgjithshme. Cilësia e raportimeve dhe mbikëqyrjes buxhetore duhet të rishikohet në mënyrë kritike dhe sistematike për të siguruar arritjen e objektivave të komunës.		Po- pjesërisht	
4.2 Planifikimi i buxhetit (çështja 7)	Kryetari duhet të siguroj se buxheti planifikohet kujdesshëm, sipas prioriteteve adekuate. Ecuria e ekzekutimit buxhetor duhet të jetë subjekt i rishikimeve të vazhdueshme, për tu siguruar se të gjitha veprimet efekte financiare janë në kuadër të parametrave buxhetor.			Jo

4.3 Të hyrat (çështja 8)	Kryetari të sigurojë se Departamenti i Financave duhet të mbledhë të gjithë informacionin e duhur për bizneset që aktivisht operojnë brenda territorit të komunës, si: numrin e bizneseve, faturimet, inkasimet, dhe borxhet e bizneseve ndaj komunës. Të aplikoj masa efektive që taksat e biznesit të inkasohen sipas periudhave të vitit, duke mos injoruar edhe borxhet e mëhershme.			Jo
4.3 Të hyrat (çështja 9)	Kryetari duhet t'i rishikojë kontratat dhe marrëveshjet për qiratë dhe shitje të pasurisë, si dhe procedurat ekzistuese në mbledhjen e taksave dhe të merr masa për rritjen e shkallës së mbledhjes së të hyrave. Departamenti i financave të raportoj çdo tre muaj për progresin.			Jo
4.3 Të hyrat (çështja 10)	Kryetari duhet të merr masa të menjëhershme për të siguruar se tarifat dhe ngarkesat tjera ndaj qytetarëve janë të bazuara në rregulloret përkatëse, dhe nëse ato mungojnë, ne do të sugjerim që ato sa më shpejtë të miratohen në Kuvend.	Po		
4.4.1 Shpenzimet (çështja 11)	Kryetari duhet të siguroj një paraqitje të qartë të projekteve në kolonat buxhetore në mënyrë që fonde të mjaftueshme të jenë në dispozicion për implementimin e tyre, dhe që nuk do të përsëriten praktikën e transferit të fondeve nga një projekt në tjetrin.			Jo

4.4.1 Shpenzimet (çështja 12)	Kryetari duhet të fuqizoj kontrollet e planifikimit të projekteve. Të bëhet vlerësim më i përafërt i kostove, për t'iu shmangur intervenimeve të mëvonshme në mbulimin e deficiteve në kontrata. Aty ku kërkohen mjete shtesë për ndonjë projekt, të ndiqen procedurat e duhura për aprovim.			Jo
4.4.2 Shpenzimet (çështja 13)	Kryetari duhet të inicioj një rishikim të arsyeshmërisë së pagesave në avans. Për më tepër, marrëveshjet duhet të sigurojnë raportimin e duhur të çështjeve financiare dhe rezultateve gjatë implementimit të projektit, si bazë e fortë monitorimi. Raportet finale, pas ekzekutimit të projektit duhet të bëhen publike si mjet transparence dhe llogaridhënie.			Jo
4.4.2 Shpenzimet (çështja 14)	Kryetari duhet të siguroj se kontrollet financiare mbi dhënien e avanceve fuqizohen për të siguruar se të gjitha shpenzimet për udhëtime janë të dokumentuara dhe në pajtim me UA për udhëtime zyrtare 2004/7	Po		
4.4.2 Shpenzimet (çështja 15)	Kryetari duhet t'i kushtoj rëndësi shfrytëzimit të parave të imëta me qëllim që këto mjete të shpenzohen vetëm për rastet e paparashikuara, siç parashihet me rregull financiare nr.01/2013.	Po		
4.4.4 subvencione dhe transfere (çështja 16)	Kryetari duhet të siguroj se vendimet për dhënien e subvencioneve do të merren vetëm pas konfirmimeve të marra nga komisioni përkatës se kërkesat për subvencione në kuptimin formal i plotësojnë të gjitha kushtet.	Po		

4.4.4 subvencione dhe transfere (çështja 17)	Kryetari duhet të sigurojë që përfituesit e mjeteve nga subvencionet të raportojnë me saktësi dhe me kohë lidhur me shpenzimet, dhe në raste të mos shfrytëzimit të mjeteve financiare për qëllime të caktuara, paratë të kthehen në llogarinë e komunës.	Po		
4.5.1 pasuritë kapitale dhe jo kapitale (çështja 18)	Kryetari duhet të siguroj, që sa më parë komisionet e caktuara të bëjnë vlerësimin e drejtë dhe të plotë të të gjithë pasurive fikse në dispozicion si dhe të konfirmojnë shkallën e tyre funksionale/ të përdorimit. Rezultatet e raporteve përfundimtare duhet të shqyrtohen nga menaxhmenti i komunës dhe të pasohen me regjistrimet e nevojshme kontabël.		Po- pjesërisht	
4.5.2 Trajtimi i llogarive të arkëtueshme (çështja e 19)	Kryetari duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative kur është e nevojshme.			Jo
4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm (çështja 20)	Kryetari duhet të siguroj se Sistemi i auditimit të brendshëm bëhet më funksional. NjAB më tepër të fokusohet në kryerjen e auditimeve në fushat e ndjeshme, si: pasuritë, proceset e prokurimit, dhe në vitet e ardhshme të përmbush aktivitetet e planifikuara. Çështjet e ngritura nga auditimi i brendshëm duhet të diskutohen dhe adresohen nga të gjitha nivelet e menaxhimit. Komiteti i auditimit të bëj një plan pune ku do t'i përcaktoj agjendat e punës dhe temat që do t'i trajtoj gjatë vitit			Jo